



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

VENDIM

Nr. 148, datë 12.04.2022

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 e 334/1 të Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri (relator), Irena Brahimi dhe Sokol Pina, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”; “Mosbindje ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik”; “Vjedhje”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia dhe Genti Dokollari, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Prodhim dhe shitje e narkotikëve, etj.”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Artan Çupi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, {...}; Objekti: “Përmbushje aktmarrëveshje”; “Sigurim padie”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Suela Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Neni 283/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Alfred Konomi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, çështjen penale me të pandehur: {...} etj; Akuza: “Nenet 284/2, 248 dhe 300 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR